

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR " F & D Ferramenta "

Në Durrës, sot në datën 31/10/2019 (Tridhjetë e një/ Tetor/ Dymijë e nëntëmbëdhjetë), ne :

1. **Francesco Vitale**, atësia Vigilante Vitale, i datëlindjes 03/06/1974, lindur në Mirabella Eclano, banues në Mirabella Eclano, (AV) Pianopantano/ SNC, pajisur me karte identiteti Nr. AT 3721361, lëshuar në datën 07/08/2012, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Devid Dermynshi**, atësia Kastriot, i datëlindjes 17/11/1998, lindur në ITA, banues në Durrës, në adresën : Rruga " Pireu ", Nr. 1, Shkozë, pajisur me Leternjoftim ID Nr. 033118899, lëshuar në datën 25/05/2016, Nr. Personal J81117063M, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 " Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " (i azhornuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit "... etj.

Themelojme shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar " **F & D FERRAMENTA** " sh.p.k.

Selia e shoqërisë është në Durrës, në adresën : Lagja Nr. 14, Rruga " Pireu ", Nr. 1, Shkozë, Autostrada Tiranë – Durrës Km 32.

Objekti i shoqërisë është :

- Shitje me pakice dhe shumice, në pika shitje dhe/ ose shitje ambulante, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të : pajisjeve hidraulike, elektrike, bujqesore, veglave të punës, të gjitha materialeve të ndertimit, mjete dhe pajisjeve shtëpiake, vajra lubrifikante, mjete dhe sistem ngrohje – ftohje, etj.
- Import, eksport dhe shitje jashtë territorit të R.SH i : pajisjeve hidraulike, elektrike, bujqesore, veglave të punës, të gjitha materialeve të ndertimit, mjete dhe pajisjeve shtëpiake, vajra lubrifikante, mjete dhe sistem ngrohje – ftohje, etj.
- Transport kombëtar dhe nderkombëtar për qelime vetjake ose për llogari të tjerë.
- Pjesëmarrje në tendera apo konkurse brenda dhe jashtë territorit të R.SH.

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **pa afat**.

Kapitali themeltar i shoqërisë është **120.000 (Njëqind e njetë mijë) Lekë, i përbërë nga 2 kuota :**

1. Nje Kuote me vlerë nominale 60'000 Leke, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar, dhe zotërohet nga unë ortakut themelues Francesco Vitale.
2. Nje Kuote me vlerë nominale 60'000 Leke, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar, dhe zotërohet nga unë ortakut themelues Devid Dermynshi.


Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anulohen në rast se janë çelur, seli, filiale, agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Administrimi i shoqërisë

Administrator i shoqërisë emërohet : z. Devid Dermynshi, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

Afati i emërimit të administratorit është 5 (pesë) vjet. Administratori emërohet sot në datën 31/10/2019 dhe afati do të përfundojë në datën 30/10/2024. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare)

Administratori do të përfaqësojë shoqërinë tregtare, kryejë veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.



Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, keto do të realizohen vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.


Pjesët e Kapitalit Themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil të R.SH. Ortaku gëzon të drejtën e shitjes së kuotave jashtë ortakërisë mbi bazën e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me nga dy faqe secila, në gjuhën shqipe, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zëmë miratohet nga ne ortaket themeluesë dhe nënshkruhet në çdo faqe.

ORTAKËT THEMELUESË

TË " F & D FERRAMENTA " SH.P.K


(Francesco Vitale)


(Devid Dermyshe)